

NJOFTIM PËR MJETET E INFORMIMIT:

Procedurë e re për caktimin e intervistave për viza joimigruese.

Duke filluar nga data 1 gusht 2004, ambasada amerikane në Shkup nuk do të pranojë caktimin e takimeve për viza joimigruese nëpërmjet të telefonimit. Vizat joimigruese përfshijnë të gjitha vizat studentore, vizat për biznes dhe ato turistike. Parashtruesit e kërkesës për vizë do të mund të bëjnë caktimin e takimit për vizë joimigruese në njërën nga këto tri mënyra:

- 1) Na faksoni një kërkesë në këtë numër:02-321-3767,
- ne do t'u përgjigjemi nëpërmjet të faksit.
- 2) Dërgoni një kërkesë për takim nëpërmjet të postës elektronike, e-mail, në këtë adresë: consularskopje@state.gov,
- ne do t'u përgjigjemi nëpërmjet të e-mali-it.
- 3) Dërgoni një kërkesë për takim me postë në këtë adresë,
Ambasada Amerikane
Spektori Konsullor
Bul. Ilinden, b.b.
1000 Shkup
Maqedoni
- ne do t'u përgjigjemi nëpërmjet të postës.

Ju lutemi, kur ta parashtroni kërkesën për takim për vizë joimigruese i përfshini këto informata:

- emrin dhe mbiemrin e plotë të parashtruesit,
- qëllimin e udhëtimit,
- datat e propozuara për udhëtimin tuaj dhe informatën për t'u kontaktuar (numrin e faksit, e-mail adresën ose adresën postale).

Në qoftë se jeni duke parashtruar kërkesë për takim nëpërmjet të postës, ju lutemi na dërgoni një zarf me adresën tuaj dhe pullë postale në të, që të mundemi t'u informojmë për takimin e caktuar, kohën dhe ditën.

Në qoftë se doni të caktoni një takim të vecantë/konkret-Ju mund ta bëni këtë, por kini parasysh se ambasada punon me viza joimigruese vetëm të haneve, mërkureve dhe të premteve në mëngjes. Kërkesat tuaja për caktim të takimit për vizë joimigruese duhet të parashtrohen përafërsisht katër deri në gjashtë javë paraprakisht nga data e propozuar e udhëtimit për në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, posaqërisht nëse bëni kërkesën nëpërmjet të postës.

Për informata plotësuese, Ju lutemi konsultoni faqen elektronike të ambasadës në këtë adresë: <http://skopje.usembassy.gov> .